



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/ A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.03.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: Pro Tech Clean SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”**, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1, Autoriteti Publik - Komuna e Prishtinës me datë: 16.03.2023 nxjerr:

V E N D I M

- Hudhet poshtë si e palejuar kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: Pro Tech Clean SH.P.K e parashtruar me datë: 15.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të AK -së, të datës 10.02.2022 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së , në bazë të nenit 108/ A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.**
- Autoriteti Publik ka sqaruar pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik Ankimor me sqarime për OE dhe ka bërë përmasimin e dosjes së tenderit.**
- Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1.**
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>**

Iu dorëzohet:

Departamentit të Prokurimit
Palës përmes sistemit elektronik - E-Prokurimi
Arkivit

Visar Shehu - U.D. – Departamenti i Prokurimit

